



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 791/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi- Kryetare, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Vedat Poterqoi- Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "El Bau" sh.p.k, me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore" me nr. të prokurimit: 651-22-5238-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Gjilanit, me datën 24.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Anulohet aktiviteti i prokurimit iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit me titull "Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore" me nr. të prokurimit: 651-22-5238-5-2-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit.

II. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ar sy e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.12.2022, Komuna e Gjilanit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore” me nr. të prokurimit: 651-22-5238-5-2-1.

Me datë 09.12.2022, Operatori Ekonomik “El Bau”sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Gjilan, me datë 12.12.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 06.12.2022 . Me datën 21.12.2022 Operatori Ekonomik “El Bau”sh.p.k”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 791/2022, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur (punë), vlerë e mesme, kriteri për dhënie të kontratës ishte: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Vlera e parashikuar e kontratës: 208,902.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç; rast AK nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 10.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “El Bau”sh.p.k të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 06.12.2022 ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër shënuar të zhvillohet në pajtim kërkesat e LPP-së dhe të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “El Bau”sh.p.k

Ndonëse OE ankues ka paraqitur 4 pretendime në ankesën e deponuar në OSHP, fokusi i kësaj analize do të jenë pretendimet 3 dhe 4 të cilat kanë të bëjnë me dy vendimet kryesore të AK-së në lidhje me OE ankues. Pretendimi nr.3 konteston arsyeshmërinë e Vendimit të AK-së për të anuluar aktivitetin e prokurimit, duke e cilësuar atë si *“të kundërligjshëm”*, ndërsa Pretendimi nr.4 konteston edhe Vendimin e AK-së për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, pasi që sipas OE ankues arsyetimi i tij *“nuk mbështetet në asnjë provë”*.

Pretendimi nr. 3

Në Pjesën 2 të këtij Raporti, është dhënë i plotë teksti i pretendimeve të OE ankues. Me pretendimin Nr.3 OE ankues konteston përdorimin e Nenit 62, paragrafi 2, pika 2.2 të LPP-së për të arsyetuar Vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Neni 62 i LPP-së që rregullon *“Përfundimin e Aktivitetit të Prokurimit”*, në paragrafin 2, përcakton arsyet të cilat duhet të plotësohen për të përfunduar një aktivitet të prokurimit dhe në pikën 2.2 definohet si në vijim: *“para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre(3) ditë para hapjes së tenderëve”*.

Pra, siç mund të shihet nga citimi i dispozitës ligjore të cilën AK e ka përdorur si bazë për të arsyetuar Vendimin e tij për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ajo rregullon një situatë të caktuar kur aktiviteti i prokurimit gjendet në fazën *“para hapjes së tenderëve”*, madje ajo specifikon që *“ndërprerja e aktivitetit të prokurimit duhet të bëhet së paku tri (3) ditë para hapjes së tenderëve”*. Së këndejmi, duke pasur parasysh që aktiviteti i prokurimit me titull *“Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore”*, me nr. identifikues 651-22-5238-5-2-1, gjendej në fazën kur OE i përgjegjshëm pritej të shpërblehej me kontratë, pas finalizimit të vlerësimit të tenderëve nga Komisioni i vlerësimit, atëherë përdorimi i Nenit 62, paragrafi 2, pika 2.2 nuk është adekuat dhe nuk e mbështet vendimin e AK-së.

Siç është argumentuar me provat që OE ankues ia ka bashkangjitur ankesës së tij, aktiviteti i prokurimit ka përmbushur të gjitha kushtet ligjore për t’u inicuar si i tillë dhe nga shqyrtimi i dokumenteve në posedim, nuk kam gjetur ndonjë dëshmi të qëndrueshme ligjore që justifikon Vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke u bazuar në dispozitën ligjore të

sipër përmendur. Rrjedhimisht, pretendimi nr.3 i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 4

Pretendimi nr.4 konteston Vendimin e AK-së për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim. Sipas OE ankues arsyetimi i këtij vendimi duke u thirrur në Nenin 22 të LPP-së “nuk mbështetet në asnjë provë”. Për më tepër OE ankues pretendon që AK nuk e ka respektuar as Nenin 48, paragrafët 1 dhe 2 të LPP-së në lidhje me kërkesat ligjore për përmbajtjen e arsytimit të aktit administrativ.

Neni 22 i LPP-së që rregullon “Inicimin e aktivitetit të prokurimit” në dy paragrafët e tij përcakton procedurat dhe kushtet që duhet të përmbushen për t’u iniciuar një aktivitet i prokurimit. Siç është thënë më lartë, bazuar në dëshmitë e bashkangjitura në ankesën e OE ankues, aktiviteti i prokurimit ishte inicuar sipas Nenit 22 të LPP-së dhe mbetet i paqartë citimi i kësaj dispozite ligjore për arsytimin e vendimit për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

Po ashtu, edhe përmbajtja e arsytimit të vendimit mund të cilësohet si jo e plotë, pasi që ajo nuk përmban të gjitha elementet që kërkohen me Nenin 48, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së. Rrjedhimisht, konsideroj që edhe pretendimi nr.4 i OE ankues është i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe procesi të zhvillohet në pajtim me kërkesat e LPP-së dhe të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, sqaron se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsytimin se “AK- KK Gjilan kanë përgatitur Dosjen e tenderit dhe sipas Njoftimit për kontratë kanë specifikuar vlerën e parashikuar 208. 902, 00 euro. Nga njësia kërkuese na është konfirmuar se nuk ka mjete për të vazhduar tutje me këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht janë të detyruar që të bëjnë anulimin e aktivitetit të prokurimit”.

Paneli shqyrtues duke u gjetur në një situatë të tillë faktike, me datën 21 shkurt 2023, kanë kërkuar sqarime nga autoriteti kontraktues të cilët kanë njoftuar panelin shqyrtues me Planifikimin përfundimtar të prokurimit të dërguar në AQP me datën 13 shkurt 2023, ku sipas këtij planifikimi AK- KK Gjilan nuk ka të paraparë realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore”, me nr. identifikues 651-22-5238-5-2-1, dhe i i tillë nuk mund të realizohej për shkak të mungesës së mjeteve financiare për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

AK ka theksuar se janë njoftuar nga njësia kërkuese se, citat: “...si njësi kërkuese rikonfirmojmë se për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore”, me nr. identifikues

651-22-5238-5-2-1, nuk kemi mjete financiare të planifikuara dhe poashtu kemi obligime financiare të trashëguara nga vitet e kaluara të cilat do të jenë barrë financiare”, mbarim citati.

- *Përfundim* -

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli. Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP.

Pasiqë, nga AK është konfirmuar se nuk ka mjete buxhetore për realizimin e aktivitetit të prokurimit, paneli shqyrtues len në fuqi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.


OSHP nisët gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkojë ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kyetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Gjilan

1x1 OE "El Bau" sh.p.k, me seli në Gjilan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.